

# **1. Titulli i projektit: Bashkëpunimi zhvillimor ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Agjencisë Suedeze të Tatimeve (STA).**

## **Afati kohor i projektit: Nëntor 2022- 2025**

Projekti i asistencës së ofruar nga administrata tatimore e Suedisë, që filloi me Fazën Fillestare 2021-2022 (*Inception Phase*), dhe vijon me zbatimin e projektit gjatë periudhës 2022-2025.

Marrëveshja mes DPT dhe Administratës Tatimore Suedeze, u nënshkrua në *1 Nëntor 2022* në ambientet e MFE-së, në prani të Drejtorit të Përgjithshëm, Ambasades Suedeze në Tiranë, SIDA-s dhe Ministrit të Financave.

Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në Shqipëri (*DPT*) dhe Agjencisë Suedeze të Tatimeve (*STA*) synon të forcojë mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Bashkëpunimi trevjeçar do të financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (*Sida*).

Objektivi kryesor i Projektit është të mbështesë DPT-në në arritjen e zhvillimit dhe progresit të nevojshëm bazuar në MTRS 2022-2026. Projekti do të mbështesë këto përparime duke u fokusuar në forcimin e qeverisjes së mirë, pajtueshmërisë vullnetare dhe zhvillimit të biznesit brenda DPT.

Nëpërmjet llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit besimi i tatimpaguesve në sistemin tatimor dhe administrimin e tij do të rritet. Kjo do të çojë në rritjen e gatishmërisë së tatimpaguesve për të përmbushur vullnetarisht, duke reduktuar në të njëjtën kohë mundësinë e evazionit fiskal, i cili do të çojë në rritjen e të ardhurave tatimore. Ky projekt do të kontribuojë në mënyrë indirekte në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) dhe do të vendosë bazat për adresimin e rekomandimit të Komisionit Evropian sipas Kapitullit 16 (Taksimi) në lidhje me gatishmërinë për të aplikuar sistemet e Teknologjisë së Informacionit (IT) të BE-së, si Vlera e Shtuar e Sistemit të Shkëmbimit të Informacionit Tatimor (VIES).

Projekti përbëhet **nga pesë komponentë** :

1. Ofrimi i shërbimit cilësor për tatimpaguesit.
2. Ndërtimi i një kulture të fortë integriteti.
3. Gjurmimi i mashtrimit tatimor.
4. Kontroll tatimor më efikas.
5. Asistencë në përdorimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në çështjet tatimore.

## **Rezultatet e pritura dhe ndikimi :**

- Janë zbatuar ose përmirësuar procese të reja për rritjen e efikasitetit të biznesit të administratës tatimore.
- Planifikimi dhe biznesi operacional bazohet në menaxhimin e riskut.
- Metodatat e reja të zhvillimit të biznesit janë zbatuar në secilin komponent.

Gjatë vitit të dytë të këtij projekti 3 vjeçar, janë realizuar:

- 2 vizita studimore për komponentin e Kontrollit Tatimor
- 15 Misione fizike në Tiranë
- 11 Takime digitale.
- 2 Webinare

Po punohet për një anketë të dytë gjithëpërfshirëse për tatimpaguesit dhe administratën tatimore, e cila do të përdoret si bazë krahasuese me rezultatet e marra nga anketa e parë si dhe do të synohet gjithashtu si input strategjik për planifikimin dhe vendimmarrjen e DPT-së. Në bashkëpunim me IDM ( Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim) u hartua dhe pritet për miratim Plani i Integritetit të Administratës Tatimore Qëndrore dhe Rajonale.